



**Ambasciata d'Italia
Pristina**

4

**DOKUMENTET E NEVOJSHME PER HEQJEN E NDALESSES SCHENGEN
HEQJE E SINJALIZIMIT SCHENGEN
SI PASOJE E PERFUNDIMIT TE PERIUDHES NDALUESE**

I nderuar aplikues,

në bazë të nenit 19 të Dekretit të Presidentit të Republikës n. 394/99 të modifikuar nga D.P.R. 334/04, ndalesa e hyrjes fillon nga data në të cilën Ju, në bazë të dekretit të përjashtimit, keni lëshuar territorin shtetëror italian, e cila, në bazë të nenit 8 paragrafi 1 të të njëjtit Dekret, vërtetohet nga vula dalëse ose nga dokumente të tjera që dëshmojnë mos-praninë Tuaj në territorin e Shtetit.

KUJDES: Ju kujtojmë që edhe pas përfundimit të periudhës së sinjalizimit heqja e emrit Tuaj nga terminali shtetëror dhe Schengen NUK është automatike.

Procedurat për heqjen e ndalesës së hyrjes janë si më poshtë vijon:

Persona me afat ndalese të përfunduar

Në këtë kategori hyjnë të gjithë ata persona të cilët kanë pasur një dekret përjashtimi, të lëshuar nga autoritetet kompetente italiane, afati i ndalesës së të cilit, në bazë të sgarimit të mësipërm, ka përfunduar.

Kompetenca mbi trajtimin e kërkesave mbi heqjen e ndalesave të përcaktuara nga dekrete përjashtimi të lëshuara nga autoritetet italiane, karshi banorëve të përhershëm të Republikës së Kosovës, periudha e të cilave ka përfunduar, i takon Ambasadës Italiane në Prishtinë.

Dokumentet e nevojshme:

- **fotokopje e një letërnjoftimi valid;**
- **kërkesa për heqjen e të dhënave personale nga Sistemi Informativ Schengen e hartuar në gjuhën italiane (ISTANZA DI CANCELLAZIONE DAL SISTEMA INFORMATIVO SCHENGEN)**
- **fotokopje eventuale e Dekretit të përjashtimit;**
- **Vërtetimin përkatës nga Ministria e Punëve të Brendshme të Italisë lidhur me statusin Tuaj;**
- **dokumentacion që vërteton daljen dhe mos-praninë e aplikuesit në territorin shtetëror.**



**Ambasciata d'Italia
Pristina**

KUJDES: Ambasada nuk ka të drejtë hyrjeje në të dhënat Tuaja personale, Ju mund të ushtroni të drejtën Tuaj për verifikimin, ndryshimin apo fshirjen e të dhënave Tuaja të pranishme në Sistemin e Informimit Schengen duke iu drejtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Italisë, Departamenti i Sigurisë Publike, Zyra e Koordinimit dhe e Planifikimit të Forcave të Policisë, Seksioni N.S.I.S. që gjendet në këtë adresë:

**Ministero dell'Interno
Dipartimento Pubblica Sicurezza
Ufficio Coordinamento e pianificazione delle forze di polizia
Divisione N.S.I.S.
Polo Anagnina, Palazzina B
Via di Torre di Mezzavia, n.9
00173, ROMA
ITALIA**

KUJDES: pas pranimit të dokumentacionit përkatës, zyrtari i Ambasadës Italiane, përgjegjës mbi procedurën administrative, pas verifikimit të përmbushjes së dispozitave ligjore në fuqi, do të lëshojë një vërtetim mbi hapjen e procedurës administrative përkatëse nëpërmjet së cilës Ju do të informoheni mbi detajet e saj.

AMBASADA ITALIANE NE PRISHTINE